

Vendim nr. 244 datë 22.10.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, në datën 22.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 11 (D) 2024 të Regjistratit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: DASHMIRA ZARO

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2388(155), datë 15.04.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përveç disponimit ndaj të paditurës, Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 17, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkesja Dashmira Zaro është bashkëpronare e një toke me sipërfaqe të përgjithshme 10 hektarë, të ndodhur në Virua, Gjirokastrë dhe të regjistruar në regjistrat e pasurive të

paluajtshme në disa pasuri të veçanta, që përfshihen në zonën kadastrale nr. 8541. Me vendimin nr. 57, datë 20.10.2011 “Për miratimin e planit rregullues të qytetit të Gjirokastrës”, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Gjirokastrë ka përcaktuar zhvillimin, vetëm për përdorim publik, edhe të pronës në bashkëpronësi të kërkueses. Në vijim, Bashkia Gjirokastrë ka kryer procedurën e prokurimit për objektin sistemim i Parkut të Viroit, rikonstruksion i rrugës dhe ndriçim, ndërkohë që operatorët ekonomikë fitues kanë filluar punimet për realizimin e objektit. Më pas, mbi kërkesën e Bashkisë Gjirokastrë, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 322, datë 15.04.2015 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit: sistemim i Parkut të Viroit, rikonstruksion i rrugës në Parkun e Viroit nga ana e qytetit, ndriçimi i trotuarit në Parkun e Viroit nga ana e qytetit” (*vendimi i shpronësimit*), ka vendosur shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit, përfshirë edhe një pjesë të pasurisë në bashkëpronësi të kërkueses, konkretisht të sipërfaqes 24.608 m². Në lidhje me pronën kërkuessa ka vënë në lëvizje disa procese gjyqësore.

Procesi i parë gjyqësor

2. Në datën 03.11.2014 kërkuessa dhe një nga bashkëpronarët e tjerë (shtetasi A.Ç.) kanë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë padi me objekt kallëzimin e një punimi të ri dhe një dëmi të mundshëm, si dhe detyrimin e të paditurve, Bashkisë Gjirokastrë, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe operatorëve ekonomikë fitues të procedurës së prokurimit, për të kthyer sendin ose paguar vlerën e plotë të pronës. Ndërsa çështja ndodhej për shqyrtim, ka dalë vendimi i shpronësimit edhe të një pjese të pronës së kërkueses. Për këtë çështje, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me vendimin nr. 3087, datë 08.06.2015, ka shpallur moskompetencën e saj lëndore duke ia dërguar aktet për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, vendim i cili, pas ankimit të veçantë të kërkueses, është lënë në fuqi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2015-4482, datë 03.12.2015.

3. Çështja është gjykuar më pas nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë e cila, me vendimin nr. 383, datë 09.06.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar Ministrinë e Zhvillimit Urban të shpërblejë palën paditëse për efekt shpronësimi në bazë të vendimit të shpronësimit në shumën totale 119,717,920 lekë, ndërsa ka rrëzuar padinë për pjesën tjetër të objektit të saj. Ky vendim, mbi ankimin e kërkueses, është prishur dhe çështja është kthyer për rigjykim nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 2276, datë 04.06.2018.

4. Në rigjykimin e çështjes, si ndërhyrës kryesorë kanë marrë pjesë edhe bashkëpronarët e tjerë të pronës, duke kërkuar edhe ata detyrimin e të paditurve që të paguajnë vlerën e plotë të

saj. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 326, datë 14.06.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit me vendim nr. 39, datë 15.02.2022, ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe pushimin e çështjes. Mbi rekursin e kërkueses, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2656 (113), datë 23.03.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, për sa i përket kërimit për vlerën e pronës, ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pushimin e çështjes për pjesën tjetër të padisë.

Procesi i dytë gjyqësor

5. Në datën 10.05.2017 kërkuësja dhe një nga bashkëpronarët e tjerë (shtetasi A.Ç.) kanë paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë një padi me objekt të saktësuar gjatë gjykimit si vijon: i) konstatimin e vendosjes së kufizimeve mbi tre tagrat e pronarit që barazohet me shpronësim të pjesës 75.392 m² të mbetur nga prona pas shpronësimit; ii) ndalimin e cenimit të tagrit të disponimit, duke urdhëruar të paditurën, Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Gjirokastrë (*ZVRPP, Gjirokastrë*), brenda 30 ditëve, të hedhë gjurmën e projektit në hartën treguese të regjistrimit sipas pikave 8 dhe 9 të vendimit të shpronësimit; iii) pushimin e cenimit të gëzimit të lirë dhe paqësor të pronës, duke detyruar të paditurën, Bashkinë Gjirokastrë, brenda 15 ditëve, të heqë barrierën e lëvizshme metalike nga rruga dhe të mos e përsërisë më në të ardhmen; iv) ndalimin e cenimit të tagrit të gëzimit dhe të posedimit të pronës ose detyrimin e të paditurve, Bashkisë Gjirokastrë dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban për nxjerrjen e akteve administrative që zgjidhin pasojat e zhvillimit të detyrueshëm të pronës/tokës sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gjirokastrë dhe/ose përdorimit të pronës në funksion të rikonstruksionit të Parkut të Viroit.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 443, datë 18.07.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë (vetëm të kërimit të dytë), duke urdhëruar ZVRPP-në, Gjirokastrë (*sot Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë*) që të hedhë gjurmën e projekteve në parkun e Viroit dhe të pajisë paditësit me certifikatë pronësie për pronën e mbetur pas shpronësimit nëpërmjet VKM-së nr. 322/2015. Për sa i përket kërimit të tretë të padisë, atij për pushimin e cenimit të gëzimit të lirë e paqësor të pronës, duke detyruar palën e paditur të heqë barrierën e palëvizshme metalike nga rruga, gjykata ka vendosur moskompetencën e saj lëndore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duke arsyetuar, në thelb, se ky kërkim padie ka natyrë civile, ndërsa jemi para një padie mohuese, që është një nga paditë kryesore për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë dhe pavarësisht se palë e

paditur është Bashkia Gjirokastrë, kompetenca lëndore për shqyrtimin e saj i përket gjykatës civile. Ndërkohë, për kërkimet e tjera të padisë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e saj për këtë pjesë. Konkretisht, për kërkimin e parë të padisë gjykata ka arsyetuar se pala paditëse e ka pronën të regjistruar në emër të saj dhe mund ta gëzojë atë sipas ligjit, ndërkohë që shpronësimi i pronës mund të bëhet me akt administrativ sipas ligjit të shpronësimeve dhe nuk mund të barazohet me asnjë veprim a mosveprim të paligjshëm ndaj pronës në cenim të tagrit të gëzimit. Kurse për kërkimin e katër të padisë, i cili përmban tre kërkime alternative, pasi ka vërejtur se objekti i tij është i përgjithshëm dhe i papërcaktuar, ndaj do t'u referohej argumenteve në pjesën arsyetuese të padisë, gjykata ka arsyetuar se pala paditëse kërkon të detyrojë palën e paditur të lidhë kontratën e shitjes të sendit, godinës së ish-stacionit të pompimit, në një kohë kur mungon vullneti i ligjshëm i palës së paditur, si dhe kur nuk provohet që sendi të jetë në pronësi të kësaj të fundit. Për sa u përket kërkimeve alternative, gjykata ka arsyetuar se palës paditëse i mungon legjitimitimi aktiv, pasi referuar vendimit të Këshillit Bashkiak Gjirokastrë dhe Rregullores Vendore të Planifikimit të Territorit, në zonën e Viroit lejohen ndërtime vetëm për interes publik, duke qenë të ndaluara ndërtimet e tjera dhe se, për më tepër, nuk provohet që paditësit t'i jenë drejtuar palës së paditur për t'u pajisur me leje zhvillimore sipas ligjit për planifikimin e territorit. Kundër këtij vendimi, për sa i përket shpalljes së moskompetencës lëndore për kërkimin e tretë të padisë, si dhe për rrëzimin e padisë për kërkimin e parë dhe të katërt, kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

7. Ndërsa çështja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, në datën 11.08.2021 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar, ndër të tjera, edhe shfuqizimin e vendimit nr. 443, datë 18.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë për pjesën e padisë që ka shpallur moskompetencën lëndore. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 118, datë 08.10.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi ka vlerësuar se kërkuesja nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

8. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 240, datë 16.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Mbi rekursin e kërkueses, me vendimin nr. 00-2024-2388(155), datë 15.04.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

Procesi i tretë gjyqësor

9. Referuar vendimit nr. 118, datë 08.10.2021 të Gjykatës së Lartë, padia e kërkueses dhe e një prej bashkëpronarëve të tjerë, në lidhje me kërkimin e tretë të saj, për të cilin Gjykata

Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë ka shpallur moskompetencën lëndore në procesin e dytë gjyqësor, pra atij për pushimin e cenimit të gëzimit të lirë e paqësor të pronës, duke detyruar palën e paditur të heqë barrierën e palëvizshme metalike nga rruga dhe duke mos e përsëritur më në të ardhmen, është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, e cila, me vendimin nr. 103 (21-2018-302), datë 26.02.2018, ka vendosur rrëzimin e padisë. Në vijim, çështja i ka kaluar për shqyrtim Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

10. Ndërkohë, referuar të dhënave të faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se kjo çështje është regjistruar pranë kësaj të fundit në datën 04.11.2022, mbi bazën e rekursit të kërkuases, dhe se ajo ndodhet ende në proces.

11. Në datën 26.06.2024 kërkuësja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, duke kundërshtuar procesin e dytë gjyqësor, me përjashtim të disponimit të gjykatave për sa i përket kërimit të dytë të padisë ndaj të paditurës Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë. Kolegji i Gjykatës në datën 23.09.2024 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuases

12. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

12.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

12.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi për kërkimin e tretë të padisë, për të cilin është shpallur moskompetenca lëndore e gjykatave administrative, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se moskompetenca lëndore është shpallur në përputhje të plotë me nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (ligji nr. 49/2012), ndërsa ky kërkim ka natyrë civile. Gjykata e Lartë nuk ka bërë asnjë vlerësim për tre kushtet e pretenduara*

në pikën 1.1 të rekursit të kërkueses, sipas orientimeve të vendimit të saj njësues nr. 2, datë 10.03.2014.

12.1.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi shpallja e moskompetencës lëndore përbën cenim të “gjësë së gjykuar”, në kushtet kur Gjykata e Lartë në vendimin e saj nr. 4482, datë 03.12.2015, të dhënë në procesin e parë gjyqësor, ka arsyetuar se ndonëse “kallëzimi i një punimi të ri” dhe “kthimi i sendit” janë padi që parashikohen në Kodin Civil, paditësi kërkon dhe “shpërblimin e dëmit të mundshëm”, që pretendon se i është shkaktuar nga veprimet e organit publik, prandaj nisur nga shkaku i padisë dhe subjektit që i kundërdrejtohet ajo, këto mjete juridike mund të ushtrohen edhe ndaj veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës publike. Në këto raste, shqyrtimi i padisë, pavarësisht se parashikohet nga legjislacioni civil, referuar dispozitave të ligjit nr. 49/2012, është në kompetencë lëndore të gjykatës administrative, pasi shkak për lindjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi janë bërë aktet dhe veprimet e palës së paditur, Bashkisë Gjirokastrë. Ndërkohë që për këtë pretendim të ngritur nga kërkuësja në rekurs Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur.

12.1.3. *Parimit të disponibilitetit të padisë*, pasi kërkitimi i katërt i padisë është rrëzuar nga gjykata administrative e shkallës së parë me arsyetimin se pala paditëse kërkon të detyrojë palën e paditur, Bashkinë Gjirokastrë dhe Ministrinë e Zhvillimit Urban, të lidhë kontratën e shitjes së sendit “ish-stacion pompimi”, në një kohë kur në padi nuk është kërkuar një gjë e tillë. Duke vepruar në këtë mënyrë ajo gjykatë ka penguar kërkuësen në ushtrimin e së drejtës së disponimit të padisë. Edhe Gjykata Administrative e Apelit, pa asnjë kontroll dhe vlerësim të pretendimeve të ngritura në ankim, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, ndërsa Gjykata e Lartë nuk i ka shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet e kërkueses për shkeljet me natyrë kushtetuese të lejuara nga gjykatat më të ulëta.

12.1.4. *Së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin në mungesë tërësore të analizës dhe vlerësimit të pretendimeve të ngritura në të, sidomos ato për ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (ligji nr. 107/2014), moszbatimi i të cilit cenon të drejtën e pronës. Ajo gjykatë nuk është shprehur për pretendimin në rekurs se vendimet e

gjykatave më të ulëta janë të paarsyetuara, kontradiktore dhe të pabazuara. Për sa i përket vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ai është kontradiktor në drejtim të argumenteve mbi cilat ka rrëzuar padinë. Në lidhje me kërkimin e parë të padisë, arsyetimi i gjykatës se pala paditëse e ka pronën të regjistruar në emër të saj dhe mund ta gëzojë sipas përcaktimeve të ligjit bie ndesh me atë që gjykata ka pranuar, se prona e mbetur pas shpronësimit nuk është regjistruar për faj të ZVRPP-së, Gjirokastrë, përveçse edhe nëse prona do të ishte e regjistruar, e drejta e pronës nuk garantohet vetëm me zotërimin formal të titullit të pronësisë. Ndërsa në lidhje me kërkimin e katërt të padisë, arsyetimi i gjykatës se ky kërkim është ngritur pa u botuar më parë në regjistër plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Gjirokastrë, bie ndesh me provat e administruara në gjykim, ku sipas shkresës nr. 245/01 prot., datë 23.02.2017 Ministria e Zhvillimit Urban/Agjencia e Planifikimit të Territorit ka konfirmuar se ky plan është botuar edhe në regjistrin e integruar të territorit në adresën zyrtare.

12.1.5. Edhe gjykata e apelit nuk ka marrë në analizë pretendimet e ngritura në ankim, por në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, ka arsyetuar se pala paditëse nuk ka aplikuar pranë të paditurave sipas kompetencave të tyre, duke qenë e paqartë se mungesës së kujt prej aplikimeve i referohet, ndërkohë që ligji nr. 107/2014 dhe ligji për shpronësimet nuk parashikojnë që pronarët duhet të “aplikojnë” pranë të paditurave për të nisur procedurat e shpronësimit, për më tepër që ky i fundit është jashtë vullnetit të pronarit. Gjithashtu, nuk ka asnjë arsyetim nga gjykata se përse nuk është i zbatueshëm neni 17, shkronja “e”, i ligjit nr. 49/2012 dhe ligji nr. 107/2014, ku paditësit pronarë bazojnë kërkimin alternativ në kërkimin e katërt të padisë. Vendimi është kontradiktor, pasi gjykata e apelit, nga njëra anë, pranon se për faj të ZVRPP-së, Gjirokastrë kërkuësja nuk disponon dokument pronësie për pronën e mbetur pas shpronësimit, ndërsa, nga ana tjetër, arsyeton se ajo nuk ka aplikuar për leje zhvillimi, në një kohë kur referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, për një aplikim të tillë duhet dokumenti i pronësisë. Ky vendim është edhe alogjik, pasi kërkuësja nuk mund të aplikojë për leje zhvillimi, sepse toka e mbetur pas shpronësimit nuk mund të zhvillohet referuar planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Gjirokastrë dhe planit të detajuar vendor, ndërsa në këtë zonë lejohen ndërtime vetëm për interes publik.

- 12.1.6. *Parimit të barazisë së armëve*, pasi Gjykata Administrative e Apelit, duke e gjykuar çështjen në dhomën e këshillimit, ka privuar kërkuesen nga e drejta për të debatuar dhe për të dhënë mendim për çështje që nuk janë pretenduar nga pala e paditur dhe as janë shtruar për diskutim nga gjykata e shkallës së parë.
- 12.2. *Të drejtën e pronës private*, kufizimi i së cilës shfaqet në formën e detyrimit për të respektuar përcaktimet e zhvillimit të detyrueshëm të tokës sipas nenit 32 të ligjit nr. 107/2014, ndërkohë që plani i detajuar vendor i zonës së liqenit të Viroit, qoftë ai i vitit 2011, ashtu dhe ai i vitit 2016, është hartuar me nismë publike dhe nuk është mbështetur asnjëherë nga pronarët e tokës. Bashkia Gjirokastrë, në respektim të parimit të proporcionalitetit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, kishte detyrimin për të filluar procedurat e shpronësimit sipas nenit 32, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 107/2014 dhe për sa kohë nuk i ka filluar ato, kërkuësja ka të drejtë të kërkojë gjyqësisht detyrimin e saj për nxjerrjen e akteve administrative që zgjidhin pasojat e zhvillimit të detyrueshëm të pronës/tokës sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Gjirokastrë për zonën e liqenit të Viroit, ndërsa fati i tokës së mbetur pas shpronësimit vijon të mbetet i pasigurt për mbi 10 vjet. Kufizimi i së drejtës së pronës ngjason me shpronësimin *de facto* pa shpërblim dhe është në atë masë që ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës, duke e bërë atë iluzive.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. *Për legjitimitimin e kërkueses*

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë

kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

15. Një kriter tjetër paraprak është shterimi i mjeteve juridike efektive, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Shterimi i mjeteve efektive përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, që para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri lidhet me dy momente: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

16. Gjykata kryen gjykimin përfundimtar të ankesave të individit, që nënkupton se çdo individ legjitimohet në ankimin individual kushtetues kundër një vendimi gjyqësor, me kusht që procesi gjyqësor i shqyrtimit të themelit të çështjes të jetë përfunduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, në kushtet kur mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar*, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor të themelit (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shkelja e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në çdo aspekt të saj, mund të pretendohet në Gjykatë pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve. Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatë ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 25.04.2017; nr. 16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se objekt i kërkesës në shqyrtim, pavarësisht se në objektin e saj kundërshtohet vetëm vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, referuar përmbajtjes së saj, janë të gjitha vendimet e gjykatave të zakonshme në procesin e dytë gjyqësor. Kundërshtimet e kërkueses konsistojnë në drejtim të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme

për sa i përket shpalljes së moskompetencës lëndore të gjykatave administrative për kërkimin e tretë të padisë dhe dërgimin e saj për shqyrtimin në gjykatën civile, duke e konsideruar atë si padi me natyrë civile. Po ashtu, kundërshtimet e saj konsistojnë edhe në drejtim të vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme për rrëzimin si të pabazuar të kërkimit të parë dhe të katër të padisë.

18. Në lidhje me vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë për shpalljen e moskompetencës lëndore për kërkimin e tretë të padisë, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ai është bërë edhe më parë objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe me vendimin nr. 118, datë 08.10.2021 të Kolegjit të kësaj Gjykate është vendosur moskalimi i kërkesës për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkesja nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ndërsa nën aspektin formal të kriterit të shterimit të mjeteve, që është shterimi i të gjitha mjeteve të zakonshme të ankimit, kërkesja e ka kundërshtuar vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë për shpalljen e moskompetencës në të gjitha shkallët e gjykimit, kjo nuk është e mjaftueshme për të konsideruar të përmbushur këtë kriter kushtetues. Në aspektin substancial të këtij kriteri vendimet gjyqësore objekt të kontrollit kushtetues duhet të kenë natyrë përfundimtare, pra të vendosin në mënyrë përfundimtare për të drejtat substanciale të individit. Në këtë kuptim, këto lloj vendimesh të gjykatave, të cilat shprehen në lidhje me çështjen e kompetencës lëndore, nuk mund të konsiderohen përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, për sa kohë ato nuk përmbysin procesin gjyqësor dhe nuk zgjidhin në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjen mes palëve ndërgjyqëse. Në këtë drejtim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se procesi gjyqësor i vënë në lëvizje për gjykimin e kërkimit të tretë të kërkesëpadisë së kërkueses është ende duke u zhvilluar në gjykatat e zakonshme, ndaj kërkesja ka të gjitha mundësitë që të kërkojë, në përfundim të atij procesi, edhe mbrojtjen kushtetuese përpara kësaj Gjykate. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohet kriteri i shterimit të mjeteve juridike në lidhje me ato disponime të gjykatave që kanë të bëjnë me çështjen e shpalljes së moskompetencës lëndore.

19. Kurse për sa i përket disponimit tjetër të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, me të cilin është rrëzuar si pabazuar kërkimi i parë dhe i katërt i padisë, kërkesja konsiderohet se ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit, pasi i është drejtuar Gjykatës pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjykimit. Për rrjedhojë, vlerësohet se ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 15.04.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 26.06.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

21. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuësja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në disa aspekte të saj, si edhe e drejta e pronës private. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, pasi Gjykata Administrative e Apelit duke shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit e ka privuar atë nga e drejta për të debatuar e për të dhënë mendim për çështje që nuk janë pretenduar nga pala e paditur. Referuar parashikimeve të dispozitave procedurale të ligjit nr. 49/2012, që rregullojnë procedurën e gjykimit në gjykatën e apelit, rezulton se shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit dhe për njoftimin e palëve zbatohen rregullat procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë (neni 49), ndërkohë që për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ajo gjykatë vendos nëse çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Kurse sipas nenit 50 të po atij ligji, Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit vendos: a) mospranimin e ankimit; b) lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; c) ndryshimin e vendimit; ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim; d) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

22. Referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se kërkuësja ka qenë pala që ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, por edhe në gjykatat më të larta, ndërsa nuk provohet dhe as pretendohet që të mos jetë njohur me prapësimet e palës tjetër, sikundër edhe me argumentet e gjykatave, pra që të jetë vënë në pamundësi për të paraqitur kundërshtimet e saj me shkrim. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se e drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht para gjykatës, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, vetëm shqyrtimi i çështjes së kërkuësës në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim të drejtën për proces të rregullt, për sa kohë që Gjykata Administrative e Apelit ka vepruar në përputhje me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë atij gjykimi, si dhe me kompetencat e saj. Për rrjedhojë ky pretendim i kërkuësës është haptazi i pabazuar.

23. Po kështu kërkuësja ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit substancial të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykatat nuk kanë marrë

në shqyrtim dhe nuk kanë analizuar pretendimet e saj, sidomos ato në drejtim të zbatimit të ligjit nr. 107/2014. Sipas kërkueses, në lidhje me kërkimin e parë të padisë, arsyetimi i gjykatës se pala paditëse e ka pronën të regjistruar në emër të saj dhe mund ta gëzojë sipas përcaktimeve të ligjit bie ndesh me atë që gjykata ka pranuar se prona e mbetur pas shpronësimit nuk është regjistruar për faj të ZVRPP-së, Gjirokastrë, por edhe nëse prona do të ishte e regjistruar, e drejta e pronës nuk garantohet vetëm me zotërimin formal të titullit të pronësisë, ndërsa në lidhje me kërkimin e katërt të padisë, arsyetimi i gjykatës se ky kërkim është ngritur pa u botuar më parë në regjistër plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Gjirokastrë bie ndesh me provat e administruara në gjykim. Sipas saj, vendimet janë kontradiktore, pasi gjykata e apelit, nga njëra anë, pranon se për faj të ZVRPP-së, Gjirokastrë kërkuësja nuk disponon dokument pronësie për pronën e mbetur pas shpronësimit, ndërsa, nga ana tjetër, arsyeton se ajo nuk ka aplikuar për leje zhvillimi, si dhe alogjike, pasi kërkuësja nuk mund të aplikojë për leje zhvillimi, sepse toka e mbetur pas shpronësimit nuk mund të zhvillohet referuar planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Gjirokastrë dhe planit të detajuar vendor, pasi në këtë zonë lejohen ndërtime vetëm për interes publik. Për rrjedhojë, sipas kërkueses, mënyra se si kanë vepruar gjykatat i kanë kufizuar asaj të drejtën e pronës private, që shfaqet në formën e detyrimit për të respektuar përcaktimet e zhvillimit të detyrueshëm të tokës sipas nenit 32 të ligjit nr. 107/2014, ndërkohë që plani i detajuar vendor i zonës së liqenit të Viroit, qoftë ai i vitit 2011, ashtu dhe ai i vitit 2016, është hartuar me nismë publike dhe nuk është mbështetur asnjëherë nga pronarët e tokës, ndërkohë që Bashkia Gjirokastrë, në respektim të parimit të proporcionalitetit, të garantuar nga neni 17 i Kushtetutës, kishte detyrimin për të filluar procedurat e shpronësimit sipas nenit 32, pika 2, shkronja “c”, të ligjit nr. 107/2014. Sipas saj, kufizimi i së drejtës së pronës ngjason me shpronësimin *de facto* pa shpërblim dhe është në atë masë që ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës, duke e bërë atë iluzive.

24. Referuar thelbit të këtyre pretendimeve të kërkueses, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se ato kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të fakteve dhe provave nga gjykatat e zakonshme, si dhe interpretimin e zbatimin e ligjit nga ato për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete, të cilat janë çështje thelbësisht me natyrë ligjore. Gjykata ka pohuar se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të fakteve dhe provave bëjnë pjesë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Mbledhja e Gjyqtarëve vëren, po ashtu, se gjykatat e zakonshme, pasi kanë marrë në shqyrtim pretendimet e parashtruara nga kërkuësja në kërkesëpadi dhe në ankimet ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, i kanë dhënë asaj përgjigje në drejtim të bazueshmërisë së tyre, duke parashtruar mjaftueshëm në pjesën

arsyetuese të vendimeve të tyre edhe argumentet mbi të cilat kanë mbështetur qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Edhe Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj, pasi e ka shqyrtuar çështjen, i ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në rekursin e kërkueses, në drejtim të bazueshmërisë së tyre. Arsyetimi i gjykatave të zakonshme nuk rezulton të jetë kontradiktor apo alogjik, në kuptimin që të bjerë ndesh me rregullat e mendimit të drejtë apo të koherencës së tyre të brendshme. Gjykata ka theksuar se nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, vetëm fakti se në përfundim të procesit gjyqësor, në të cilin kërkuësja ka pasur mundësinë të ushtrojë garancitë dhe të drejtat e saj procedurale, është dhënë një vendim jo në favor të saj, nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të kundërshtuar prej saj. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se edhe këto pretendime të kërkueses janë haptazi të pabazuara.

25. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve, çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d”, “dh” dhe “e” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.